

28 Korrik Dita Botërore e Hepatitit

Çdo vit në 28 korrik, Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe partnerët e saj organizojnë Ditën Botërore të Hepatitit për të rritur informimin dhe ndërgjegjësimin për hepatitin viral dhe për pasojat që ai shkakton.

Në Ditën Botërore të Hepatitit, Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe partnerët e saj ju bëjnë thirrje politikëbërësve, stafit shëndetësor dhe publikut, të mendojnë përsëri në lidhje me këtë “vrasës të heshtur”.

Dita Botërore e Hepatitit ofron një mundësi për t'u përqendruar në veprime specifike, të tilla si: *forcimi i parandalimit, depistimi dhe kontrolli i hepatitit viral dhe i sëmundjeve të lidhura me të, rritja e mbulimit vaksinal kundër hepatitit B, integrimi i vaksinës në programet kombëtare të imunizimit, si dhe koordinimi i një përgjigjeje globale ndaj hepatitit viral.*

Në Ditën Botërore të Hepatitit, Organizata Botërore e Shëndetësisë përqendrohet në faktin se edhe pse barra e sëmundjeve të shkaktuara nga hepatiti viral është në rritje, ajo mbetet e injoruar në masë të madhe apo edhe e panjohur për shumë prej politikëbërësve, personelit shëndetësor dhe publikut.

Pavarësisht nga shifrat tronditëse që hepatiti ka mbi shëndetin, ai mbetet një grup i sëmundjeve që janë kryesisht të panjohura, të nëndiagnostikuara dhe të patrajtuara.

Dita Botërore e Hepatitit është një mundësi më e madhe informimi për hepatitin, si një problem global i shëndetit publik, si dhe një nxitje për forcimin e masave parandaluese dhe kontrollin e kësaj sëmundjeje.

Në Ditën Botërore të Hepatitit, Organizata Botërore e Shëndetësisë u bën thirrje qeverive të të gjitha vendeve për të vepruar me aksione konkrete kundër virusit të hepatitit. Në veçanti, virusi i hepatitit B dhe C mund të çojë në sëmundje kronike me efekte të mëdha negative të tilla si kanceri i mëlçisë dhe cirroza, si dhe kosto ekonomike të lidhura me trajtimin dhe shpenzimet e larta mjekësore për qindra miliona njerëz në mbarë botën.

Hepatiti viral është referuar si një “epidemi e heshtur” sepse shumica e njerëzve nuk e kuptojnë që janë të infektuar, dhe infeksioni përparon ngadalë në sëmundje të rënda të mëlçisë.

Shumë vende vetëm tani janë duke kuptuar përmasat e barrës së sëmundjes dhe po gjejnë mënyra për t'u përballur me të.

Për më tepër shiko: <http://www.ishp.gov.al/shendeti-riprodhues/>